

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, ZNJ. NERTINA KOSOVA

07/19/2018

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 17.07.2018 për subjektin e rivlerësimit, znj. Nertina Kosova , bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 18.07.2018, vendosi:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Nertina Kosova, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Krimet e Rënda.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjyquese e kryesuar nga znj. Firdes Shuli, z. Olsi Komici relator, z.Roland Ilia anëtar, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.